

Ky pyetësor është hartuar për tu ardhur në ndihmë Autoriteteve Lokale dhe Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor. Strukturat e mësipërme kanë për detyrë të marrim të gjitha masat dhe të kryejnë kontrollet e nevojshme për të siguruar që Qendrat e Votimit në të gjithë vendin, të jenë të aksesueshme lirisht nga zgjedhësit me aftësi të kufizuar.

Udhëzimi nr.01, datë 12.12.2012 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “PËR MËNYRËN E NGRITJES DHE CAKTIMIT TË VENDNDODHJES SË QENDRAVE TË VOTIMIT DHE PËRGATITJEN E HARTËS SË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE PËR ZGJEDHJET”, parashikon se:

Vendndodhja e qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- a. të jetë me sipërfaqe minimumi 30 m²;
- b. të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;
- c. të jetë mjedis me ndriçim të mjaftueshëm;
- d. të jetë në katet e para të objekteve.

Gjithashtu Neni 7 i këtij Udhëzimi parashikon se Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore, merr masa për:

- a. krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuar;
- b. dërgimin në KQZ të listës së votuesve me aftësi të kufizuar dhe votuesit e verbër brenda periudhës së rishikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhor.

Kujdes!

Çështjet e ngritura më poshtë në pyetësor janë shumë të rëndësishme pasi kushtet fizike të QV-ve janë të lidhura në mënyrë të pashmangëshme me ushtrimin ose jotë së drejtës për të votuar nga personat me aftësi të kufizuar.

Ju këshillojmë:

Të merrni me vete një metër për të matur gjerësinë e dymve.



Ju këshillojmë:

Të siguroheni që rampat (sipërfaqet e pjerrëta) ekzistuese ose të reja të kenë një pjerrësi jo më të madhe se 12%.



Ju këshillojmë:

1. Të siguroheni që rampat dhe hyrjet të mos jenë të zëna sin ë foton e mëposhtëme.
2. Të mos ketë objekte në hyrje dhe korridore të cilat pengojnë zgjedhësit e verbër.

NR	ÇËSHTJE	PO	JO	VEPRIME QË DUHET TË KRYHEN
1	Karakteristikat e jashtme të vendit			
	▪ A është hapësira përpara Qendrës së Votimit me terren të ashpër dhe të papërshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar në lëvizje? (psh. me gropa, me balte, zhavor, pellgje me ujë etj)			
	▪ A ka hapësirë për parkim për personat me aftësi të kufizuar që mbërrijnë pranë QV me automjetin e tyre?			
	▪ A ka ndërtesa në të cilën ndodhet Qendra e Votimit rampë në hyrje të saj?			

	▪ A është hyrja e ndërtesës me gjerësi të mjaftueshme? (minimumi 1.2 m*)			
	▪ A është hyrja e ndërtesës dhe Qendra e Votimit të vendosura në katin e parë?			
	▪ Nëse nuk ka rampa, të bëhet njoftimi në KQZ në mënyrë që të sigurohet vendosja e rampave të përhershme në ndërtesa.			
2	Korridoret e brendshme drejt vendit të votimit (nëse ka)			
	▪ A ndodhen dyer/mure në gjendje të tillë që mund të krijojnë rrezik?			
	▪ A është korridori drejt vendit të votimit i parrëshqitshëm dhe me gjerësi të mjaftueshme (minimumi 1.2 m*)?			
	▪ A ndodhen pragje ose shkallë si pjesë e korridoreve drejt vendit të votimit?			
	▪ A është i mjaftueshëm ndriçimi përgjatë korridorit?			
	▪ A ka shenja që tregojnë Qendrën e Votimit? (për të lehtësuar personat që nuk dëgjojnë)			
	▪ A perceptohet lehtësisht në ndërtesë orientimi për tek Qendra e Votimit? (për personat me aftësi të kufizuar intelektuale)			
3	Hyrjet në Qendrat e Votimit			
	▪ A ka prag/rampa të lëvizshme në hyrjen e Qendrës së Votimit?			
	▪ A ka hyrja gjerësi të mjaftueshme? (minimumi 1.2 m*)			
	▪ Nëse “Jo”, a ndodhet hyrje tjetër alternative për personat me aftësi të kufizuar që përdorin karrige me rrota?			
	▪ A ka ndriçim të mjaftueshëm në hyrje?			
	▪ A ndodhen pragje ose shkallë në hyrje drejt vendit të votimit?			
4	Veçori ndihmëse në vendin e votimit (lehtësira)			
	▪ A sigurohet hapësira e duhur për lëvizje të shpejtë dhe të lirshme			

	<i>për procesin e votimit?</i>			
	▪ <i>A është ndriçimi efektiv?</i>			
	▪ <i>A ka hapësirë të mjaftueshme për të vendosur postera udhëzues për zgjedhësit në lidhje me rregullat gjatë procesit të votimit?</i>			
*	<i>Për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar që përdorin karrige me rrota.</i>			

Kujdes: Cfarë nuk duhet të ndodhë!

